



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:293334
Datë: 20.08.2024
Numri i dokumentit: 06068263

P.nr.13/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Zubin Potok - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Mersiha Čalaković Pllana, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit: I.M, për shkak të veprës penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të Kodit (nr. 06/L-074) Penal Të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2132/23, të datës 22.12.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 06.08.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të dëmtuarit B.J, si dhe të pandehurit I.M, në po të njëjtën ditë shpalli publikisht, ndërsa me datë 20.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

I.M, nga i ati R..., e ëma F..., e vajzërisë T..., i lindur me datë ..., në M..., me adresë të vendbanimit në rrugën “...” në M..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i shtatë fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 14.07.2023, rreth orës 11:00 në fshatin Zupq – Komuna Zubin Potok, me dashje e përdor forcën ndaj të dëmtuarit B.J, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje rreth nxjerrjes së zhavorrit në lumin Ibër, në atë mënyrë që pasi fillimisht ky i fundit e thirr në telefon të pandehurin dhe bisedojnë rreth problemit të zhavorrit, pas pak e thirr tani i pandehuri përmes numrit të telefoni 044-477-650, duke i kërkuar të takohen tek vend punishtja (seperacioni) dhe me të arritur tek

vendi i dëmtuari takon patrullën e policisë, dhe në prani të tyre shkëmbejnë fjalë ofenduese ndërsa i pandehuri në një moment e godet të dëmtuarin me grusht prapa në kokë,

- Me këtë ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

-

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, si dhe nenit 184 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 358, 364, 449, 462 të KPP-së, i :

S H Q I P T O N

-DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim - gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj në dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

-Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) euro, po ashtu edhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

-Pala e dëmtuar B.J, për kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.

A R S Y E T I M

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2132/23, të datës 22.12.2023, ndaj të pandehurit I.M, për shkak të veprës penale: Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 06.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Arjan Xhema, të dëmtuarit B.J, si dhe të pandehurit I.M.

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues. I njëjti ka shprehur keqardhje dhe pendim për rastin e ndodhur dhe ka theksuar se me të dëmtuarin kanë marrëdhënie të mira.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve lidhur me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, ka japur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ashtu që i propozoi Gjykatës ta miratoj pranimin e fajësisë, pasi që është bërë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Gjykatës i propozoi që i njëjtin të shpallet fajtor, duke marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

I dëmtuari B.J, i propozoi Gjykatës ta miratoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe shtoi se me të pandehurin kanë marrëdhënie të mira tani.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri I.M, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti fillestar i incidentit i datës 14.07.2023; Raporti i oficerit i datës 14.07.2023; Mostra mbi përdorimin e forcës e datës 14.07.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarit – dëshmitarit B.J i datës 14.07.2023; Procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit i datës 14.07.2023; Foto albumi nga shkresat e lëndës; si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale sipas aktit akuzues.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimin të fajësisë nuk mundet ta shfrytëzojë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi

i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri I.M është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilat akuzohet, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprë ligjvënësi ka paraparë dënim gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin I.M, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese ka vlerësuar, dashjen direkte të pandehurit lidhur me veprën penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij, si dhe sjelljen e tij para kryerjes së kësaj vepre penale, asi që i njëjti edhe me parë ka qenë subjekt i procedurës penale, ku pas verifikimit nga data baza (SQEP), konfirmohet se ndaj të njëjtit janë edhe pesë Aktgjykime të plotfuqishme, dhe atë: P.nr.1185/2019, i plotfuqishëm me datë 23.03.2020; P.nr.33/2020 i plotfuqishëm me datë 02.11.2020; P.nr.25/2020 i plotfuqishëm me datë 13.05.2021; P.nr.27/2018, i plotfuqishëm me datë 30.09.2019 dhe P.nr.17/2021 i plotfuqishëm me datë 28.10.2021.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, keqardhje dhe pendimin e shprehur publikisht për veprimet e kryera penale, faktin se me të dëmtuarin kanë raporte të mira, si rrethanë personale, Gjykata ka pasur parasysh se tani për tani i njëjti është i pa punë, mbajtës i vetëm i familjes dhe baba i shtatë fëmijëve. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që akuzohet, që në hapje të shqyrtimit fillestar të kësaj çështje.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, Gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e

tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, Gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit bazuar në nenin 462 të KPP-së, ashtu që të dëmtuarin e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Zubin Potok

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.13/2023, datë 20.08.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja

Mersiha Čalaković Pllana

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.